



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT

Drejtoria	Drejtoria e Shëndetësisë
Periudha Raportuese	Maj, 2020
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Dr. Bujar Gashi, drejtor i DSH-së
Përgatitur	Dr. Fatlinda Hoxha – zyrtare për shëndetësi, DSH

1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Gjatë muajit maj 2020, Drejtoria e Shëndetësisë ka pranuar lëndë të ndryshme për tu shqyrtuar nga komisioni profesional. Stafi i Drejtorisë ka pasur takime të përditshme me qytetarë, për t'u njoftuar me procedura dhe shërbime sipas interesit dhe kërkesave të tyre.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues, të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj.

- Renovime dhe përmirësimeve të infrastrukturës në objekte shëndetësore;

- Monitorim dhe mbështetje të aktiviteteve bazuar në kontratat aktive;
- Monitorimi i mbarëvajtjes së punës në përditshmëri të personelit shëndetësor në QKMF dhe njësitë e saja, si dhe në QMU;
- Identifikimi i nevojave për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore në kuadër të KPSH-së;
- Inicimi i përgatitjeve administrative zbatimi i planit të prokurimit 2020;
- Përpilimi i raporteve të ndryshme në kuadër të Drejtorisë.

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë:

- Përgatitje të raporteve bazuar nga kërkesat e pranuar në DSH:
 - Monitorim i performancës së komunave, ofrim i të dhënave nga institucionet KPSH;
- Identifikimi i nevojave rreth përpilimit të specifikave:
 - Renovimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së objekteve shëndetësore KPSH;
 - Furnizim me inventar për nevojat e objekteve shëndetësore – KPSH;
 - Furnizim me pajisje mjekësore – KPSH;
 - Përmirësimi i hapësirës dhe ndriçimit publik;
 - Sigurimi i automjeteve të KPSH-së;
- Monitorim i aktiviteteve:
 - Renovimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së objektit QMU;
 - Furnizim me pajisje emergjente mbrojtëse;
 - Furnizim me pajisje mjekësore për QKMF dhe QMU - Ritender Loti 1;
 - Dixhitalizimi i objekteve shëndetësore KPSH;
 - Faza e parë – Dezinsektimi hapësinor në komunën e Prishtinës;
 - Dezinsektimi i objekteve KPSH dhe autoambulancave;
 - Vazhdim i aktivitetit – deratizimi pranveror (eliminimit të brejtësve) i rrjetit të kanalizimit, bodrumeve dhe garazheve publike nëpër lagjet e Prishtinës;
- Përfundim i specifikave për aktivitetin:
 - Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve shëndetësore;
 - Sigurimi fizik i objekteve shëndetësore KPSH;
- Përcaktim i stafit vlerësues për aktivitetin:
 - Furnizim me material shpenzues mjekësor dhe laboratorik;
 - DDD e objekteve shëndetësore;
- Monitorimi i mbarëvajtjes së përditshmërisë të personelit shëndetësor në QKMF dhe njësitë e saj, si dhe në QMU;
- Takime të vazhdueshme me menaxhmentin QKMF dhe QMU, në lidhje me përditshmërinë e punës me qytetarë:
 - Me prioritet ndërmarrjen e masave preventivë rreth parandalimit të koronavirusit;
 - Njoftim i vazhdueshëm rreth riorganizimit të personelit shëndetësor mbi gatishmërinë e përhapjes së koronavirusit;

- Në QKMF, QMF V dhe QMF IV, shërbimet u ofruan 24 orë, ndërkaq QMF-të tjera ofruan shërbime 7:00 - 19:00; Puna u organizua në tri ekipe (një ditë punë 12 orësh - dy ditë pushim);
- Tenda vazhdon të qëndrojë në oborrin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, që të shërbejë për triazhimin e pacientëve të cilët kishin simptoma të COVID-19; Gjithashtu, në këto hapësira janë marrë mostrat nga të dyshimta për virusin SARS-CoV-2, në kohën 10:00 deri në orën 13:00 për t'u testuar.



- LDS Charities dhuron pajisje mbrojtëse për stafin shëndetësor të Qendrës së Mjekësisë Urgjente;

- Udhëzimet për mbrojtjes së qytetarëve dhe stafit nga Covid- 19 u vendosën në hyrje të objekteve shëndetësore të KPSH-së;
- Gatishmëri e 4 ekipeve të QMU-së dhe 5 veturave për transportimin e pacientëve të dyshuar dhe pozitiv në Covid- 19;
- Dërgimi i ekipeve mjekësore 24/7 në pikën kufitare Mutivodë;
- Organizimi 24/7 i pikës në Qendrën studentore, apo karantina kryesore në nivel të vendit;
- Dezinfektim i të gjitha objekteve shëndetësore KPSH, si dhe dezinfektim kontinuel në objektet me frekuentim më të shpeshtë nga qytetarët, në veçanti QKMF dhe Tenda;
- Tuneli dezinfektues vazhdon të qëndrojë në oborrin e Qendrës Kryesore për Mjekësi Familjare, pranë tendës së triazhimit, si masë mbrojtëse shtesë për parandalimin e përhapjes së #Covid- 19.
- Personel shëndetësor, përveç në objekte shëndetësore publike, KPSH ishte i angazhuar me përkushtim edhe në:
 - Karantinën e Qendrës Studentore;
Tendën në oborrin e QKMF-së, nga data 27.03.2020: Orari i punës 07:00 - 13:00, 13:00- 19:00, 19:00- 07:00, tri ekipe (mjeku familjarë dhe infermieria);
 - Qendra e Mjekësisë Urgjente me 4 ekipe;
 - Pika kufitare në Mutivodë, filluar nga data 09.03.2020, me orar 07:00 - 20:00 dhe 19:00 - 7:00, prandaj u organizuan dy ekipe (mjeku familjarë dhe infermieria);
 - AMF e Studentëve;
- Edhe gjatë periudhës raportuese, filluar nga data 19.03.2020, vazhdoi orari i punës 07:00- 19:00, 19:00 - 07:00, dy ekipe (mjeku familjar dhe infermieria);

- Në të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare, në hyrje të tyre, ishte vendosur ekip e përbërë nga mjeku familjar dhe infermiera, ekip ky që bënte triazhimin e pacientëve;
- Gatishmëri ofrimi të shërbimeve shëndetësore 24/7 e personelit shëndetësore QMU, gjithmonë duke respektuar masat mbrojtëse individuale;
- Gjatë periudhës raportuese janë shënuar 18 raste pozitive me Covid-19;



- Kryetari i Komunës së Prishtinës, z. Shpend Ahmeti së bashku me Vedat Bajramin, pjesëtarin grupit “Stupcat”, mbollëm disa fidanë pranë QMF-së në Bregun e Diellit.



- Rifillon vaksinimi i fëmijëve, i ndërprerë për shkak të përhapjes së Covid-19, në të gjitha institucionet e shëndetit parësor shëndetësor në Prishtinë.

Sipas rekomandimeve të Institutit Kombëtar për Shëndetësi Publike, me mbështetjen e UNICEF-it, u ndërmarrën të gjitha masat e nevojshme mbrojtëse për fëmijët. Në Qendrat e Mjekësisë Familjare, të cilat shërbimin e vaksinimit e kanë të përbashkët me shërbimet tjera, u vendosën tenda, ku do të ofrohet shërbimi i vaksinimit. Ndërsa Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare dhe disa qendra të cilat kishin hyrje të veçantë për këtë shërbim, vaksinimi u realizua brenda objektit.

- Filluan procedurat e prokurimit për projektin e ndërtimit të Qendrës së Mjekësisë Familjare në Veternik;
- Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësi, Bujar Gashi, priti në vizitë në Qendrën e Mjekësisë Familjare nr. 5, Kryetaren e Kuvendit të Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani, dhe përfaqësues të UNICEF-it;
- Hope CMSE nga Ambasada e SHBA-së, në bashkëpunim me FSK-në, dhuruan pajisje mbrojtëse për personelin shëndetësor në Prishtinë.

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues:

- Identifikimi i nevojave për ofrimin e shërbimeve shëndetësore cilësore edhe gjatë gjendjes emergjente si pasojë e pandemisë globale;
- Identifikimi i nevojave për lehtësimin e punës së përditshme të personelit shëndetësor edhe gjatë gjendjes emergjente si pasojë e pandemisë globale;
- Përgatitje teknike për vlerësimin e lëndëve rreth subvencioneve shëndetësore.

5. STATISTIKAT

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.

5.1.1. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese

Fondi burimor	Planifikuara	Alokuara	Shpenzuara	Nr. i lëndëve
Pagat	7,140,000	700,331.75	700,331.75	
Mallra dhe shërbime	1,360,000			
10	622,047.00	505,000.00	76,334.95	32
21	387,953.00		26,898.00	25
Komunali	310,000.00	155,000.00	2,511.84	2
Kapitale	1,190,000.00			
21		425,000.00	49,446.65	3
22		599,738.46	110,900.00	1
Gjithsej		2,385,070.21	966,433.19	63

- Raport - deklarim të borxheve më të vjetra se 30 ditë;
- Deklarimi për ATK-në;
- Raport mujor për shpenzimet e realizuara dhe për të hyrat nga bashkëpagesat për shërbime shëndetësore;
- Raport për bartje të mjeteve për drejtorin e financave;
- Raportimi i detyrimeve për përgatitjen e pasqyrave financiare;
- Pranim të faturave dhe arkivimi i tyre;
- Përgatitja e dokumenteve të nevojshme për procedim të mëtutjeshëm;
- Zotimi;
- Dërgimi i lëndëve për procedim të mëtutjeshëm në prokurim dhe Financa;

-Përgatitja e deklaratave te disponueshemërisë për procedura të prokurimit.

5.1.2. Takimet me palë

5.1.3. Takimet me institucione të tjera:

- Drejtorja e investimeve kapitale;
- Drejtorja e Prokurimit;
- Drejtorja e Arsimit;
- Zyra për të drejtat e komuniteteve;
- Zyra për të drejtat e njeriut dhe barazisë gjinore;
- Drejtorja e Parqeve.

5.1.4. Diskutime publike/takime me qytetarë

Raportime të përditshme me media lokale: RTV 21, RTV Dukagjini, TV Klan dhe RTK.

5.1.5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

5.1.6. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër

Gjatë muajit raportues u proceduan 3 lëndë.

5.1.7. Përfitues të subvencioneve

5.1.8. Takime të tjera

- MSH,
- IKSHP.

6. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë:

- Mungesa e stafit në DSH;
- Mungesa e shefit të DSH-së tani e sa vite;
- Trajnime të ndryshme të personelit të DSH-së - përgjegjësitë e përditshme zyrtare;
- Numri i jo mjaftueshëm i stafit shëndetësor, bazuar në nevoja të qytetarëve;
- Buxhet jo i mjaftueshëm, sidomos për kategorinë “Mallra dhe shërbime”, ku me rritjen e numrit të pacientëve dhe shërbimeve, rrezikojmë shërbimet e vazhdueshme deri në fund të vitit.

7. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR PERIUDHËN PASUESE

- Përgatitjet për publikimet e tenderëve, bazuar në planin e prokurimit;
- Monitorim i përditshmërisë së personelit për të ndikuar në shërbime shëndetësore cilësore dhe të qasshme;
- Pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme profesionale.

8. TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.

QENDRA KRYESORE E MJEKESISE FAMILJARE

Ka vazhduar organizimi i brendshëm, i përshtatur me situatën epidemiologjike, për ofrimin e shërbimeve shëndetësore. Në shumicën e QMF-ve është zbatuar orari i punës: 07:00 – 19:00, përderisa në QKMF, QMF V dhe QMF IV puna ka vazhduar pa ndërprerje për 24 orë. Puna është organizuar në tri ekipe (një ditë punë 12 orësh – dy ditë pushim). Ky organizim i punës është bërë për të përballuar nevojat dhe kërkesat për zbatimin e masave, rekomandimeve dhe obligimeve tonë kundruall parandalimit dhe frenimit të pandemisë COVID-19, përkundër mungesës së numrit të mjaftueshëm të personelit, krahas gjithashtu mbulimit të tri pikave tjera të përkohshme të ofrimit të shërbimeve:

1. Ekipet kujdestare (mjeku familjarë dhe infermiera) në pikën kufitare Mutivodë kanë vazhduar kujdestarinë 24 orë (31 persona të vizituar);
2. Tri ekipet kujdestare (mjeku familjarë dhe infermiera) në TENDË – QKMF që vazhduan të funksionojnë sipas orarit 07:00 – 13:00, 13:00- 19:00, 19:00- 07:00; (**112 vizita dhe 653 strisho të marra gjatë muajit maj 2020**);
3. Dy ekipet kujdestare (mjeku familjar dhe infermiera) në AMF në Qendrën e Studentëve me orar punë 07:00- 19:00, 19:00 – 07:00 deri më 29 maj 2020; (gjatë muajit maj 2020, ekipet tona në QS vizituan **1317 persona** të rikthyer dhe të vendosur në karantinë).

Në të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare, në hyrje janë vendosur ekipet e përbëra nga (mjeku familjar dhe infermiera) për triazhimin e pacientëve. Gjatë kësaj periudhe kohore është kërkuar nga personeli shëndetësor ndërprerja e shfrytëzimit të pushimeve vjetore dhe rritja e kujdesit dhe kritereve për shfrytëzimin e pushimeve mjekësore.

Vazhdimisht janë bërë vizita monitoruese, duke vizituar të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare (ndërrimi i paraditës, pasditës dhe ndërrimi i natës) dhe janë konstatuar të gjeturat vijuese:

- ✓ Të gjithë ishin në vendet e tyre të punës;
- ✓ Respektohen rregullat e përgjithshme;
- ✓ Furnizimi me pajisje dhe masa mbrojtëse ishte i mirë;

- ✓ Masat parandaluese në nivelin e duhur;
- ✓ Të gjithë të pajisur me masa mbrojtëse (maska, doreza, dezinfektues);
- ✓ Në të gjitha qendrat vërehej rënie e numrit të pacientëve;
- ✓ Pastërtia qëndron në nivel të lartë.

Poliklinika e Stomatologjisë dhe Shërbimi stomatologjik - Funktionale në QMF II, QMF IV, QMF V, Poliklinika e Stomatologjisë, orari i punës: 07:00 – 19:00, puna është e organizuar në tri ekipe, një ditë punë 12 orësh - dy ditë pushim.

Shërbimi i vaksinimit - Orari i punës 07:00 – 19:00, tri ekipe, një ditë punë 12 orësh - dy ditë pushim. Gjatë kësaj kohe ka vazhduar vaksinimi i fëmijëve të porsalindur me BCG, Hepatit dhe vaksinimi i personave të lënduar me TeA1 dhe Tetabulinë.

Nga data 4 maj 2020, në koordinim me Zyrën e UNICEF-it në Prishtinë, drejtoresha Hadri dhe shefja e Njësisë së vaksinimit, Dr. Canolli, rikthyen shërbimin e rregullt të vaksinimit Në kuadër të masave të rekomanduara nga IKSHPK për parandalimin dhe luftimin e pandemisë janë zbatuar në vazhdimësi masat mbrojtëse për personelin, si dhe janë vendosur tendave në ato QMF ku vaksinimi ka qenë i përbashkët me shërbimet e tjera. **Gjatë muajit maj, 2020 janë administruar 2453 vaksina.**

Shërbimi laboratorik - Përveç shërbimeve laboratorike të rregullta, është mundësuar edhe marrja e strishove në Tendën para objektit të QKMF-së, nga ora 10:00 deri në orën 13:00. **Gjatë muajit maj 2020 janë marrë 653 mostra.**

Përndryshe, gjatë muajit maj 2020 janë realizuar gjithsej:

- ✓ 31353 vizita mjekësore,
- ✓ 27493 shërbime shëndetësore,
- ✓ 22738 shërbime laboratorike,
- ✓ 6718 shërbime stomatologjike,
- ✓ 969 shërbime radiologjike.

TË TJERA:

Gjatë këtij muaji janë pranuar donacione nga zyra e UNICEF-it në Kosovë, pajisje personale mbrojtëse dhe dezinfektues. Donacione të tilla janë pranuar edhe nga projekti HOPE-CMS dhe Ambasada e SHBA-së në Kosovë, si dhe nga OJQ “Bane vet”.

REKOMANDIME

1. Marrë parasysh fluksin e vogël të udhëtarëve në pikëkalimin kufitar në Mutivodë, propozojmë tërheqjen e ekipit kujdestarë nga QKMF prej kësaj pike, edhe për shkak të mungesës së personelit;
2. Shpalljen e konkursit për pranim të punonjësve të rinj, për shkak të pozitave të mbetura bosh nga pensionimi i stafit (rreth 40 pozita);
3. Planifikimin e nevojave për PPM dhe pajisjeve tjera medicinale për përballimin e valës së dytë të pandemisë me COVID-19 në vjeshtë;

QENDRA E MJEKESISE URGJENTE

Në QMU gjatë periudhës raportuese është punuar sipas orarit të rregullt të punës, me 4 ekipe mjekësore.

Mesatarisht, gjatë 24 orëve ishin 60 deri 80 intervenime në terren.

Mesatarja e intervenimeve në terren ishte rreth 70 raste për 24 orë.

Nga raportimet e stafit mjekësor, rastet urgjente janë trajtuar sipas prioriteteve të triazhës, ku kanë dominuar rastet me:

- Kriza hipertenzive,
- Bronchit acut,
- Colikat abdominale,
- Reaksionet alergjike,
- Gjendjet anksyozo -depressive,
- Gjendjet febrile etj.

Vizitat janë kryer sipas thirrjeve në linjën, tel. **194** dhe triazhimit në Qendrën Dispeçerike.

Ekipeve mjekësore ofruan shërbime në Qendrën e Studentëve, e cila shërbeu si qendër e karantinimit për qytetarët e Kosovës të kthyer nga bota e jashtme.

Me kërkesë të ekipeve mjekësore të QKMF-së, u transportuan 34 pacientë në Klinikën Infektive si të dyshuar për infeksion me COVID 19+.

Ekipeve mjekësore vazhduan kujdestaritë në orar 12 orë ditën dhe natën në pikën kufitare në Mutivodë edhe gjatë muajit maj.

Gjithashtu, ekipeve të QMU-së, janë përgjigjur në thirrje policore, në Qendrën e Mbjajtjes së Azilantëve dhe Refugjatëve në fshatin Vrandidoll, meqë rast me identifikimin e rasteve pozitive ofruan edhe transport në Qendrën Emergjente ose Klinikat e QKUK-së.

Në të gjitha intervenimet në terren ekipeve përdoren masat mbrojtëse, doreza, maska, rroba mbrojtëse, kalaqe dhe kapela.

Furnizimi me materiale, doreza, maska kirurgjikale, maska me filtër, veshje, dezinfektues, alkool, mantele kirurgjikale, syze mbrojtëse, mburoja për fytyrë, kalaqe janë siguruar nga MSH-Departamenti Farmaceutik, Drejtoria e Shëndetësisë dhe disa donacione. Nuk kemi pasur deri tani asnjë punëtor të infektuar me COVID- 19, fal kujdesit dhe përdorimit të masave mbrojtëse. Aktualisht, kemi dy infermierë bashkëshortë në vetizolim, me rekomandim të IKSHP-së, pasi që vajza e tyre ka rezultuar me COVID- 19+.

Menaxhmenti së bashku me stafin shëndetësor (mjek dhe infermier), me kujdes dhe vazhdimisht përcolli situatën epidemiologjike me pandemin COVID- 19, duke zbatuar rekomandimet e ISHKP-së dhe OBSH-së.

Më 18 maj u mbajt ligjëratat përmes platformës elektronike ZOOM. Titulli i ligjëratës:

“Emergjencat Gastroenterologjike dhe qasja e trajtimit paraspitalor”. Ligjërues ishte prof. dr. spec. Skender Telaku, që vjen nga Klinika e Gastroenterologjisë me Hepatologji të QKUK-së. Ligjëratat zgjoi interesim dhe u vlerësua nga ana e mjekëve dhe infermierëve, pasi që u mbajt pas një pauze dymujore nga shkaku i pandemisë, kur dihet se ende vazhdon ndalesa e mbajtjes së ligjëratave në salla.

Në fund, duhet të theksojmë bashkëpunimi e mirë me qytetarë, përkrahja e vazhdueshme nga DSH, MSH, IKSHP, Klinika Infektive, Qendra Operative Emergjente dhe Policia kanë qenë si gjithnjë në nivel, për çka jemi shumë falënderues.

Shërbimet dhe vizitat shëndetësore në QMU – maj 2020:

Vizita mj. urgjente në terren	1073
Vizita mj. të tjera	138
Vizita mjekësore në QMU	0
Shërbimi i kirurgjisë së vogël	0
Shërbimi i rea. në terren	7
Shërbimi i rea. në QMU	0
Observim (INTENZIV)	9
Shërbimi i infermierisë	8
Aksidentet	47
Fatkeqësitë në punë	18
Fatkeqësi të tjera	32
Shërbimi laboratorik	12
EKG	50
Transportet	240
Konstatim vdekjeje	49
GJITHSEJ	1683